

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. K. nga fsh. R, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II.nr.1078/18 të dt.15.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë **30.11.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë – Prokurorit Mone Syla, përfq. ligjor të dëmtuarës B. J., si dhe të akuzuarit A. K., mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. K.** nga fsh. R. K Gjakovë, me banim në Prishtinë, rr”...” ..., data e lindjes ..., i biri i S. dhe i nënës F. e gjinisë Gj., ka te kryer shkollim universitar banakier, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar me ID

Bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Se:

- nga data e pa vërtetuar e gjere me 16.11.2017 , ne shtëpinë e tij ne fsh. R. K Gjakovë, me qellim që vetit ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm, ne kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te ligjit për energji elektrike te R. Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike ne atë mënyrë qe njehsori elektrik me nr. 62251937, ka hequr bllobat distributive dhe përmes kablllos furnizuese prapa tabelës është lidhur direkt ne rrjetin elektrik ,këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuarës K. –Distrikti ne Gjakovë, i ka shkaktuar dem ne vlere prej 192.78 euro .

-me çka do te kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1078/18 të dt.15.08.2018, e ka akuzuar të akuzuarin A. K. nga fsh.R, K Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, me propozimin që pas vlerësimit të gjitha provave të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari të shpallet fajtor dhe te dënohet ne baze te ligjit.

I akuzuari A. K., gjatë shqyrtimit fillestar me dt.16.11.2018, duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë se për veprën penale me te cilën akuzohet edhe përkundër faktit se demi kinse i shkaktuar te dëmtuarës i është paguar ,mirëpo unë jetojë dhe punojë qe 6 vite ne Prishtinë ,andaj edhe nuk e di se kush e ka kryer veprën penale me qene se unë nuk e kam kryer ,i propozoi gjykatës qe te ftohet ne cilësi te dëshmitarit vëllai K. K.apo familjaret tjerë te cilët jetojnë ne

atë shtëpi dhe janë shfrytëzues te këtij njehsori, andaj lidhur me këtë gjykatës i propozoi qe te caktohet shqyrtimi gjyqësor dhe heqi dore nga mbajtja e shqyrtimit gjyqësor .

Pef. I autorizuar i te dëmtuarës B. J., gjatë shqyrtimit gjyqësorë të dt. 30.11.2018, deklaroi se pas dëgjimit te dëshmitarit këtu K. K.dhe pagesës ne tërësi te rikthimit te humbjeve –demit ,ne vlere prej 192.78 euro , e cila rezulton se është paguar ne tërësi. Sot u vërtetua se këtë pagës dhe keqpërdorimi dyshohet se e ka kryer dëshmitari K. K..Në këtë kuptim tërhiqemi nga ndjekja penale për te akuzuarin A. K. .

Prokurori i shtetit Mone Sylja deklaroi deklaroi se me qe perf. i autorizuar i te dëmtues ne këtë fazë te procedurës pas dëgjimit te dëshmitarit K. K. tërhiqem nga kallëzimi penal ndaj këtu te akuzuarit A. K. ,me qene se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesi i kësaj vepre penale rezulton te jete shfrytëzuesi këtu K. K., e qe kjo e rrethanë u vërtetua edhe nga vete dëshmitari –vëllai i te akuzuarit i cili pranohë ne tërësi se keqpërdorimin e ka bere vetë dhe është shfrytëzues i vetëm i këtij njehsori dhe se edhe kompensimin e demit e ka bere vet ,andaj tërhiqem nga ndjekja penale ndaj këtu te akuzuarit A. K. dhe mbetet qe pala e dëmtuar te ngritë kallëzim penale te ri ndaj te dëshmitarit K. K..

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit, Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.606/18 të dt.30.11.2018.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.